VENDIM
Nr. 463, datë 30.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 387, DATË 13.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT TREGTARE, PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE TREGTARE, PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E NEVOJSHËM PËR RIMËKËMBJEN E AKTIVITETIT TREGTAR TË NDIKUAR NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID-19, SI EDHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE TË MARRËVESHJES SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 387, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Linja e garancisë shtetërore, që lëshohet në favor të secilës bankë tregtare, është, si më poshtë vijon:

- Raiffeisen Bank Albania sh.a. deri në vlerën	4 100 000 000 lekë;
- Banka Tirana sh.a. deri në vlerën	1 250 000 000 lekë;
- Banka Union sh.a. deri në vlerën	300 000 000 lekë;
- Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. deri në vlerën	1 200 000 000 lekë;
- Banka Kombëtare Tregtare sh.a. deri në vlerën	500 000 000 lekë;
- Banka OTP Albania sh.a. deri në vlerën	2 200 000 000 lekë;
- Banka Procredit sh.a. deri në vlerën	600 000 000 lekë;
- Banka Alpha Albania sh.a. deri në vlerën	950 000 000 lekë;
- Banka Amerikane e Investimeve sh.a. deri në vlerën	1 300 000 000 lekë;
- Banka Credins sh.a. deri në vlerën	1 500 000 000 lekë;
- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. deri në vlerën	300 000 000 lekë;
- Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a. deri në vlerën	800 000 000 lekë.".

2. Ndryshimi sipas pikës 1, të këtij vendimi, të reflektohet edhe në marrëveshjet e garancisë të lidhura me bankat tregtare përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe